



Zëri i Grave Kosovare

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Në Këtë Numër

Rrugëtimi për në shtëpi.....2
Vlerësimi konstaton punën e RrGGK si shumë relevante dhe efektive.....3

Pjesëmarrësit e Dokufestit duskutojnë gjininë dhe profesionet.....3

Filmi “Një Jetë Ndryshe” shfaq jetën e personave me aftësi të kufizuara.....4

Gratë Aktive avokojnë për ti dhënë fund dhunës në familje.....4

Vullnetarët e Korpusit të Paqes Mësojnë për të Drejtat e Grave në Kosovë.....4

Regjisorët “Tregojnë rrëfimet e tyre” në Dokufest.....5

RrGGK Falënderon Praktikantët tona të Shkëlqyeshme.....6

Feministet e Reja të Kosovës do t'i bashkangjiten Karavanit Ndërkombëtar.....6

 Faqja në Facebook

 Lista e dërgesave të E-lajmeve

Drejtorja Ekzekutive e RrGGK-së, anëtare e Grupit Këshillues të Kombeve të Bashkuara lidhur me Rezolutën 1325

Igballe (Igo) Rogova, Drejtore Ekzekutive e RrGGK, mori ftesë nga UN Women në New York që të bëhet anëtare e Grupit të Ekspertëve Këshillues të Nivelit të Lartë për Studimin Global lidhur me implementimin 15 vjeçar të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (RKSOKB) 1325. Studimi përputhet me Rezolutën 2122 të Këshillit të Sigurimit, e cila bën thirrje për Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara që në tetor të vitit 2015 të bëjë një rishikim të nivelit të lartë për gratë, paqen dhe sigurinë. Studimi do të shqyrtojë punën e arritur në këtë fushë gjatë 15 viteve të fundit, duke përfshirë sukseset, sfidat dhe rekomandimet për që në të ardhmen të vazhdohet me zbatimin e plotë të RKSOKB 1325. Autore kryesore e këtij studimi do të jetë [Radhika Coomaraswamy](#).

E miratuar në vitin 2000, RKSOKB 1325 është rezoluta e parë e Kombeve të Bashkuara (KB) që adreson në mënyrë specifike ndikimin unik dhe shpesh herë disproporcional, që konfliktit i armatosur ka tek gratë. Në veçanti, ajo bën thirrje për mbajtjen e një perspektive me bazë gjinore në të gjitha proceset e pas konfliktit, programimin e KB-së, dhe të misioneve të Këshillit të Sigurimit, si dhe për të pasur trajnim me bazë gjinore në operacionet e KB-së në mbështetje të paqes. Përveç kësaj, ajo kërkon pjesëmarrje të barabartë të grave në të gjitha përpjekjet për të çuar më tej paqen dhe sigurinë.

Rogova ka qenë avokuese ndërkombëtare dhe vendore për zbatimin e RKSOKB 1325 që nga miratimi i saj në vitin 2000. Menjëherë pas luftës në Kosovë, ajo përdori Rezolutën për të kërkuar më shumë takime mes zyrtarëve të KB-së, vendim-marrësve ndërkombëtarë dhe grave në Kosovë. Znj. Rogova gjithashtu ka luajtur rol të rëndësishëm në krijimin e Koalicionit të Grave për Paqe që bashkoi gratë nga Kosova dhe Serbia të cilat bazuar në Rezolutën 1325, kërkonin të kenë rol në negociatat mes vendeve të tyre, si dhe në krijimin e Lobit Rajonal të Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore.

Znj. Rogova ka avokuar për më shumë se një dekadë për zbatimin e kësaj Rezolute të rëndësishme në vendin tonë. Në vitin 2014, Kuvendi i Republikës së Kosovës zyrtarisht miratoi Planin Kombëtar të Veprimit për Zbatimin e RKSOKB 1325. Plani i veprimit obligon Agjencinë për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit që të krijojë dhe udhëheqë një Sekretariat ndër-Institucional për të siguruar zbatimin e Rezolutës.

Nën udhëheqjen e Rogovës, RrGGK ka publikuar disa raporte lidhur me RKSOKB 1325. Në vitin 2011, RrGGK publikoi një raport gjithëpërfshirës të titulluar 1325: Fakte dhe Fabula, një përmbledhje rrëfimesh dhe faktesh lidhur me zbatimin e Rezolutës në Kosovë. Publikimi inovativ është përdorur nga North Atlantic Treaty Organization (NATO) dhe specifikisht nga Forcat e NATO-s në Kosovë (KFOR), në mesin e akterve të tjerë vendor dhe ndërkombëtarë për ngritjen e vetëdijes lidhur me Rezolutën 1325. RrGGK poashtu ka qenë e përfshirë edhe në monitorimin e Zyrës Ndërlidhëse Evropiane të Ndërtimit të Paqes (EPLO) lidhur me implementimin e RKSOKB 1325 në Evropë. Studimi i ardhshëm global do të bazohet në shqyrtimet e mëparshme të nivelit të lartë, përfshirë rishikimin e dhjetë vjetorit të RKSOKB 1325 në vitin 2010 dhe në Studimin e Sekretarit të Përgjithshëm për Gratë, Paqen dhe Sigurinë të vitit 2002. Studimi ka për qëllim harmonizimin me iniciativat tjera të mëdha të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë rishikimin 20-vjeçar të Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim nga Konferenca e Katërt Botërore për Gratë, si dhe formulimin e Agjendës së Zhvillimit Post-2015. Kjo paraqet mundësinë që studimet dhe rekomandimet e tyre të informojnë njëra-tjetrën dhe të sigurojnë një agjendë koherente, gjithëpërfshirëse për të drejtat dhe barazinë e grave.

Rrugëtimi për në shtëpi

Nga Shqipe Malushi

Qindra gra nga organizatat anëtare të RrGGK dhe përfitueset e tyre i'u bashkuan punëtorive dhe seance individuale mbi "Mirëqenien e Grave" në fshatra dhe qytete në mbarë Kosovën nga 4 qershori deri me 1 shtator 2014. Punëtoritë kanë ndihmuar gratë të reflektojnë në të kaluarën dhe të gjejnë mënyra të reja për të ecur përpara. Ky udhëtim te gratë ishte i dhimbshëm. Kujtimet e luftës ishin ende shumë të freskëta në mendjet e tyre dhe askush nuk i kishte ndihmuar ato të shërohen apo t'u japin mjetet e nevojshme që të lirojnë dhimbjet dhe ëndërrat e këqija në mënyrë që të gjejnë falje. Në qytetin e Gjakovës, gratë mbajtën fotografitë e vajzave dhe djemve të tyre të zhdukur që nga lufta. Ato qajten me orë të tëra për padrejtësinë e bërë, pafuqinë dhe mungesën e mbështetjes. Pas orëve të zisë, lirimi erdhi duke i kujtuar viktimat në dritën e të gjallëve: duke vënë në pah vlerat dhe cilësitë e tyre, e jo humbjen e tyre; duke u fokusuar në kontributin e tyre, e jo në zhdukjen e tyre.

"Gjatë këtyre 15 vjetëve unë kurrë nuk jam ndjerë me lehtë se sot," tha një nënë. "Ju jeni me vonesë, ne kemi pasur nevojë për këtë 15 vite më parë."

Në një fshat tjetër ku shumë gra ishin përdhunuar, e quanin veten "gratë pa fytyrë", pa shpresë. Kishte shumë histori që ta copëtonin zemrën. Një nënë u përdhunua nga nëntë ushtarë. Ajo u betua të luftoj këtë akt të ligë për pjesën tjetër të jetës së saj për të mbrojtur vajzat e saj. Ajo inkurajoi gratë e tjera që të ngrihen dhe të jenë krenare që kanë mbijetuar. Ajo i'u kërkoi që të mos e bartin barrën e turp-it, sepse ato nuk ishin fajtoresh për këtë akt. Së bashku kemi arritur të ndërtojmë një urë shprese, një rrjet mbështetës në anë të menduarit pozitiv dhe një vizion të ri për jetën. Në Prizren shumë të rinj me aftësi të kufizuara i'u bashkuan punëtorisë, duke gjetur shpresë për të ardhmen e tyre. Një vajzë e verbër, e para në Kosovë që studioi për diplomën master në drejtësi, shprehu dëshirën për të studjuar psikologjinë në Turqi. Ne e lidhëm atë me një universitet turk që shprehu dëshirën për t'i ofruar asaj një bursë.

Në fshatin Krushë e Vogël, ku pothuajse të gjithë burrat u vranë, gjysma e fshatit kishte lëvizur përpara. Nga një makinë qepëse e vetme që i'a kishin dhuaruar në vitin 2003, një grua kishte tani 10 makina dhe kishte punësuar shumë gra si rrobaqepëse të suksesshme. Anëtarët e RrGGK i konsideruan puntoritë si një rifreskim. Ato më dhanë një mundësi për t'u lidhur me dhimbjet e njerëzve të tjerë dhe së bashku ne e kthyem dhimbjen në shpresë. Ne krijuam një platformë pozitiviteti ku gratë mund të identifikojnë dhimbjen e tyre, t'i përkushtohen shërimit dhe të lirojnë dhimbjen e tyre. Puntoritë ndihmuar gratë të lidhen në mes vete, të falin dhe të lënë të kaluarën mbrapa. Mësuan mënyra të reja të mendimit kritik dhe të komunikimit. Shumë gra rikthyen vetëbesimin e tyre në krijimin e një jete më të mirë. Për mua, ky rrugëtim i kthimit në shtëpi ishte shumë i thellë. Isha në gjendje të lidhem me vendim tim; popullin tim; ta kujtoj trashëgiminë time; të zbuloj disa nga mangësitë e mija, që unë gjithashtu duhet t'i lë prapa.

Dashuria është në çdo zemër të popullit tim që kanë nevojë për shërim në mënyrë që të ecin përpara dhe t'i ringjallin të gjitha vlerat e tyre, të cilat ja u hoqën. Unë jam e vendosur të ngris zërin tim dhe të ju kërkoj të gjithë profesionistëve, artistëve dhe veprimtarëve humanitarë t'i ndihmojnë popullit tim të shërohet dhe të ndërtojë një vizion të ri të shpresës.

E lindur në Pejë, Kosovë, Shqipe Malushi ka jetuar në SHBA që nga viti 1980. Një aktiviste për të drejtat e grave, ajo ka punuar në New York dhe ka udhëtuar nëpër gjithë botën, duke ofruar trajnime, shërim dhe fuqizim të grave dhe burrave. Këtë verë, pas shumë vitesh, ajo u rikthye në shtëpi në Kosovë.



Vlerësimi konstaton punën e RrGGK si shumë relevante dhe efektive

RrGGK kaloi një vlerësim afatmesëm, të suksesshëm e të pavarur, të skemës së Fondit të Grave të Kosovës (FGK) dhe mbështetjes për Grupet Avokuese të Grave (GAG) komunale. Projekti që u vlerësua, i mbështetur nga Austrian Development Agency dhe Kvinna till Kvinna, kërkon të rrisë dhe të përmirësojë pjesëmarrjen e grave në vendim-marrje në nivel komunal. FGK ofron grante për anëtarët e RrGGK, duke iu mundësuar atyre që të përmirësojnë kapacitetet e tyre organizative dhe avokuese, përdorisa ndërmarrin iniciativa të përshtatura për të adresuar sfidat në komunat e tyre dhe më gjerë.

Vlerësimi afatmesëm ka vlerësuar punën e RrGGK-së si "shumë të rëndësishme" për nevojat e Kosovës. Projekti gjithashtu është konsideruar shumë relevant për Planin Strategjik të RrGGK-së për vitet 2011-2014. Më tutje, raporti ka konstatuar se projekti ka bërë një progres të madh në të gjitha rezultatet e pritura, dhe për këtë arsye është në rrugën e duhur për të arritur rezultatet e pritura dhe qëllimin e përgjithshëm të projektit. Raporti vlerësoi se rezultatet e arritura deri më tani ka shumë të ngjarë që të jenë të qëndrueshme edhe pas përfundimit të projektit.

Sipas raportit, progres i mirë është bërë drejt qëllimit të krijimit të pesë GAG-ve të reja dhe mbështetjen e punës së tetë të tjerave. Deri tani, tre GAG të reja (në Dragash, Drenas/Gllogovc dhe Podujevë) janë krijuar dhe Grupet kanë forcuar kapacitetet e tyre me mbështetjen e RrGGK-së. Ato kanë ndërmarrë disa nisma të suksesshme të avokimit në nivel komunal në drejtim të avancimit të barazisë gjinore.

Në lidhje me FGK, raporti erdhi në përfundim se projekti tashmë ka sjellë "ndryshime të dukshme pozitive" si në nivelin individual, ashtu edhe në atë organizativ. Individualisht, u vërejt se përfaqësuesit e anëtareve të RrGGK dhe përfituesit e projektit ndër të tjera janë fuqizuar me aftësi, njohuri nga trajnimet dhe organizimet e ndryshme, dhe kontakte të rrjetëzimit, si rezultat i projektit.

Në nivelin e organizimit, anëtarët e RrGGK shfaqën kapacitet më të fortë të zhvillimit (veçanërisht në lidhje me ciklin e menaxhimit të projekteve, zbatimit të projektit, raportimit, mbledhjes së fondeve dhe avokimit) dhe përmirësuan proceset dhe procedurat e brendshme. Gjatë intervistave me përfituesit e granteve, shumë prej tyre theksuan përkrahjen e vazhdueshme që kanë marrë gjatë zbatimit të projektit, gjë për të cilën ata besojnë se u ka ndihmuar të përfundojnë projektet e tyre me sukses, të fitojnë aftësi të reja dhe të forcojnë organizatat e tyre në përgjithësi.

Raportin e plotë mund ta [lexoni në faqën tonë të internetit](#).

Pjesëmarrësit e Dokufestit diskutojnë gjininë dhe profesionet

Me 21 gusht 2014, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), organizoi tryezën e rumbullakët të titulluar "Profesionet nuk kanë gjini", në kuadër të Dokufestit në Prizren.

Diskutimi u koncentrua në mënyrat se si akter të ndryshëm mund të formojnë perceptimet e popullatës mbi barazinë gjinore, veçanërisht mbi gjininë dhe punësimin. Diskutimi u moderua nga Donjeta Morina, Asistente e Projektit në UNDP dhe pjesëmarrësit diskutuan idetë dhe eksperiencat e tyre personale.

Diskutimi u fokusua në rezultatet e raportit të Pulsit Publik mbi gjininë, i cili u publikua në korrik 2014. Raporti ka rekomanduar më shumë ngritje të vetdijësimit mbi gjininë dhe profesionet, gjininë dhe punësimin.

Pjesëmarrësit i diskutuan mënyrat se si shoqëria i formon dhe vazhdimisht i riprodhon normat sociale të cilat na limitojnë zgjedhjen e karrierës varësisht prej gjinisë sonë.

Debati filloi me shfaqjen e klipit "Profesionet nuk kanë gjini", i cili tregon aspiratat e karrierës së djemve dhe vajzave. Diskutimi u fokusua në mënyrat e ndryshme se si familja, media, shkolla dhe shoqëria e limitojnë zgjedhjen e karrierës së vajzave dhe djemve të vegjël, duke imponuar norma të ndryshme sociale mbi ta.

Donjeta Morina tha se është "e kënaqur me mënyrën se si ka shkuar diskutimi dhe që personalisht ka mësuar shumë prej të gjithë pjesëmarrësve".



Me 21 Gusht 2014, UNDP organizoi tryezë të rumbullakët me titullin Profesionet nuk kanë gjini.

Filmi “Një Jetë Ndryshe” shfaq jetën e personave me aftësi të kufizuara

Biletat e filmit u shitën tri orë para se të fillonte filmi. Kjo rriti kuriozitetin e audiencës mbi këtë film, i cili u shfaq në “Kino mbi Lum” me 20 gusht, në [Dokufest](#). Kush kishte bileta shikoi filmin prej kinemasë, ndërsa kishte edhe shumë të tjerë që shikonin prej së largu.

Filmi, Fotografia: Një Jetë Ndryshe u prodhuan prej [Organizatës së Personave me Distrofi Muskulare të Kosovës \(OPDMK\)](#). Filmi tregoi storien e një puntorie të fotografisë, e cila ndryshoi jetën e një grupit të njerëzve me aftësi të kufizuara. U prodhuan pa fonde, në baza vullnetare.

Antigona Shestan, Drejtore Ekzekutive e OPDMK, tha që filmi ishte i veçantë pasi që personat që merrnin pjesë në puntorinë e fotografisë të mbajtur prej Nafis Llokvica e kanë përfunduar kursin pavarësisht prej aftësive të tyre të kufizuara.

“Kemi punuar shumë për ta përfunduar këtë film dhe nuk kemi pritur që kaq shumë njerëz kanë me na përkrahë” tha ajo. “Jam shumë, shumë e gëzuar që kaq shumë persona kanë ardhë me e pa filmin tonë”

“Ky film nuk është film mbi personat me aftësi të kufizuara, por për personat me aftësi të kufizuara”, tha Faldim Vagangjiu. “Aftësitë e tyre të kufizuara nuk i ndalojnë që të jenë fotografë të suksesshëm.”

Gratë Aktive avokojnë për ti dhënë fund dhunës në familje

Femrat Aktive të Gjakovës (FAGj), një organizatë anëtare e RrGGK, po punon drejt implementimit të ligjit për mbrojtje kundër dhunës në familje. Ato po punojnë me gra dhe vajza të të gjitha etniciteteve sidomos me ato Romë, Ashkalike dhe Egjiptiase (RAE), për të siguruar që dhuna në familje po trajtohet me drejtësi dhe në shtrirje të plotë të ligjit në Kosovë.

Edhe pse [Ligji për Mbrojtje kundër dhunës në familje \(Nr.03/LI82\)](#) vendos një kuadër mjaft të plotë për trajtimin e dhunës në familje në vend, ai nuk implemetohet plotësisht. Gratë dhe të rinjtë ende nuk kanë qasje të barabartë për mbrojtje kundër dhunës dhe sistemi për sigurimin e informacionit në lidhje me ndihmën në dispozicion mbetet joefikas. Kjo është veçanërisht e dukshme te Romët, Ashkalitë dhe Egjiptasit.

“Ne jemi të vetëdijshëm që dhuna në familje ndodh edhe te gratë e arsimuara që qëndrojnë mirë finaciarisht, dhe ne jemi të gatshme të punojmë me gra të komuniteteve dhe profileve të ndryshme. Por, siç e kemi vënë re, numri më i madh i grave që kërkojnë ndihmë në OJQ-në tonë për çështjet e dhunës në familje janë: Romet, Ashkaliket dhe Egjiptaset; është shumë i vogël numri i grave që kanë vijuar mësimet dhe nuk qëndrojnë mirë ekonomikisht”, tha Valbona Rizvanolli, Drejtoreshë Ekzekutive e Femrave Aktive të Gjakovës.

Kështu, FAGj ka ndërmarrë një iniciativë për të ofruar sesione informative mbi tema duke përfshirë dhunën në familje në përgjithësi, ligjet të cilat kanë të bëjnë me dhunën në familje dhe strategjitë për monitorimin e zbatimit të Ligjit kundër dhunës në familje në Komunën e Gjakovës.

Përveç kësaj, ata kanë punuar në botimin e një raporti monitorues mbi zbatimin e këtij ligji, duke përfshirë edhe të gjeturat dhe rekomandimet.

“Është shumë e rëndësishme që të ketë ligjërata të tilla me gra nga komuniteti ynë, por edhe me burrat e tyre, fëmijët dhe anëtarët e tjerë të familjes”, tha Tabe Maliqi, një anëtare e komunitetit. “Familjarët e tyre duhet të jenë të informuar për pasojat që do të përballen në rast se ata ushtrojnë dhunë ndaj pjesëtarëve të familjës së tyre.”

Duke organizuar këto aktivitete, OJQ Femrat Aktive të Gjakovës ka për qëllim të sigurojë që ligjet ekzistuese për mbrojtje kundër dhunës në familje janë aplikuar dhe zbatuar në Gjakovë. Ato kërkojnë gjithashtu të ndihmojnë gratë të bëhen më të vetëdijshme në lidhje me ligjin dhe të drejtat e tyre në bazë të tij.

“Pas punëtorisë do ta shoh efektin e ligjeratës”, tha Sakibe Doli, Drejtore Ekzekutive e Shtëpisë të Sigurtë në Gjakovë, e cila strehon gratë dhe fëmijët që kanë përjetuar dhunë. “Më parë, në lagje e fshatra të tjera ku ne kemi mbajtur këto ligjerata, rezultatet kanë qenë gjithmonë të menjëhershme. Ndërgjegjësimi i tyre u rrit dhe ata ndërmorrën veprime për të ndaluar dhunën në familje.”

Puna e FAGj është mundësuar nga një grant përmes [Fondit të Grave të Kosovës](#) të RrGGK, mbështetur nga [Austrian Development Agency](#) dhe [Kvinna till Kvinna](#).



Vullnetarët e Korpusi të Paqes Mësojnë për të Drejtat e Grave në Kosovë

Me 8 Gusht, Igballe Rogova, Drejtore Ekzekutive e RrGGK iu drejtua rreth 20 vullnetarëve të Korpusit të Paqes për pozitën e grave në Kosovë. Vullnetarët janë grupi i parë i tillë që do të dalin në Kosovë. Ata iu nënshtruan një trajnimi gjuhësor dhe teknik tre-mujor, të plotë dhe ndër-kulturor para se të niseshin nga regjionet e tyre specifike nga i gjithë vendi për të dhënë mësim në gjuhën angleze në shkollat fillore.

"Në emër të Misionit tonë të SHBA, unë jam krenare që po mbështes Korpusin e Paqes në hapjen e vendit të tyre më të ri këtu në Kosovë", tha Tracey Jacobson, Ambasadorja e SHBA-ve në Republikën e Kosovës. "Ne jemi të ngazëllyer nga perspektiva e vullnetarëve që punojnë me qytetarët e Kosovës, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm për komunitetet në të gjithë vendin. Miqësitë që ata krijojnë do t'i shërbejnë popullit të Kosovës dhe të Shteteve të Bashkuara për vitet që vijnë."

Programi i [Korpusit të Paqes](#) në Kosovë filloi me 9 shtator 2013 me një ceremoni zyrtare nënshkrimi, në zyrën e Presidentes së Kosovës në Prishtinë. Ftesa për fillimin e këtij programi u bë nga Atifete Jahjaga, [Presidente e Kosovës](#), që nënshkroi marrëveshjen së bashku me Helen Lowman, ish-Drejtoreshë Rajonale e Korpusit të Paqes dhe Drejtoreshë aktuale për Rekrutimin dhe Përzgjedhjen e Vullnetarëve.

"Me përkrahjen e madhe të USAID-it dhe Departamentit të Shtetit të SHBA-ve, Korpusi i Paqes pret me padurim që të krijojë një program aktiv dhe të qëndrueshëm në Kosovë," tha Lowman pas ceremonisë së nënshkrimit.

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, Kosova u bë shteti i 140-të i shërbimit të Korpusit të Paqes që nga themelimi i tij në vitin 1961. Gjithashtu është hyrja e parë e organizatës në një vend të ri që nga hapja e programit në Kamboxhia në vitin 2007. Stafi i Korpusit të Paqes vizitoi Kosovën pas nënshkrimit të marrëveshjes dhe ka punuar së bashku me qeverinë e Kosovës për të identifikuar komunitetet lokale që do të shërbehen më mirë nga vullnetarët e agjencisë. Me 20 gusht, Presidentja Jahjaga [mirëpriti](#) vullnetarët e Korpusit të Paqes.

Vullnetarët e Korpusit të Paqes poashtu inkurajohen që të marrin pjesë në projekte shkollore dhe të komunitetit. Kjo ofron mundësi për të ndarë përvojat, për të shkëmbyer aftësitë dhe njohuritë dhe për të krijuar mirëkuptim të mirëfilltë ndërmjet vullnetarëve dhe komuniteteve nikoqire. Qasja e Korpusit të Paqes është ndërtuar mbi rëndësinë e këmbimit të ideve në nivel bazë, njerëzit-për-njerëzit. Që nga themelimi i tij nga ana e presidentit amerikan John F. Kennedy në vitin 1961, më shumë se 210.000 amerikanë kanë dalë vullnetarë në të gjithë globin. Misioni i Korpusit të Paqes është për të promovuar paqen dhe miqësinë botërore duke përmbushur tri qëllime kryesore: të ndihmojë njerëzit e vendeve të interesuara në përmbushjen e nevojave të tyre për burra dhe gra të trajnuar; të ndihmojë në promovimin e një kuptimi më të mirë të amerikanëve nga ana e popujve të shërbyer; dhe të ndihmojë promovimin e të kuptuarit më të mirë të popujve të tjerë nga ana e amerikanëve. Aktualisht, vullnetarët janë duke punuar në komunitetet lokale në fushat e fokusit të bujqësisë, zhvillimit ekonomik të komunitetit, arsimit, mjedisit, shëndetit dhe zhvillimit të rinjve.

Regjisorët "Tregojnë rrëfimet e tyre" në Dokufest

Gjatë festivalit gjallërues dhe multi-kulturor [Dokufest](#), në Prizren një nga punëtoritë e organizuara ishte *"Stories we tell"* (Rrëfimet që tregojmë). Kjo punëtori inkurajoi regjisorët e rinjë të ndajnë ide për tregime dhe të mësojnë se si të bëjnë dokumentare lidhur me të drejtat e njeriut.

Në mesin e pjesëmarrësve ishte dhe Koordinatorja për Marrëdhënie me Publikun nga [RrGGK](#), Donjeta Berisha. Punëtorinë e udhëheqi regjisorin dhe kinematografi, Richard Pearce, regjisorin i filmave *"Hearts and Minds"* dhe *"Road to Memphis"*. Në këtë punëtori intensive tre ditore pjesëmarrësit u ndanë në grupe, duke xhiruar në vende të ndryshme të qytetit.

"Ishte një përvojë e mrekullueshme," tha një pjesëmarrëse. "Nganjëherë nuk mund ti realizonim planet si i mendonim dhe na duhej improvizim, ishte e mrekullueshme sa të dedikuar ishim të gjithë."

Pjesëmarrësit shëtitën qytetin, duke tentuar të gjenjë vendet e nevojshme për të përfunduar detyrat e tyre. Pas filmimit gjatë ditës, ata u kthyen për të diskutuar punën e tyre me njëri-tjetrin dhe Richard Pearce. Ai u mahnit nga kreativiteti dhe idetë e mrekullueshme të pjesëmarrësve. Ai premtoi që bashkëpunimi nuk do të ndalet edhe pas përfundimit të Dokufestit. Do të vazhdoj edhe në të ardhmen. Gjatë festivalit, pjesëmarrësit poashtu patën mundësinë të shohin shumë filma dhe të zhvillojnë idetë e tyre, të cilat ata i paraqitën para jurisë. Juria u ofroi pjesëmarrësve këshilla dhe strategji për sfidat e radhës. Pjesëmarrësit kanë një muaj kohë për të përgaditur idetë e tyre dhe t'i dërgojnë jurisë, e cila do të zgjedhë tetë filma që do të financohen nga dokufesti dhe do të shfaqen vitin e ardhshëm.



Pjesëmarrësit duke diskutuar idetë në punëtorinë "Tregimet që rrëfejme" në Dokufest. Foto: Patrik Gllozhani

RrGGK Falënderon Praktikantet tona të Shkëlqyeshme



Çdo vit, [RrGGK](#) ofron praktikë për studentë nga Kosova dhe jashtë Kosovës. Këtë verë ne mirëpritëm dy vullnetare nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Jennifer Davidson nga Dartmouth College në Pennsylvania dhe Monique Nicole Morin nga New School në New York. Jennifer dhe Monique punuan gjatë verës në zyret e RrGGK duke ndihmuar dhe dhënë një kontribut jashtëzakonisht të madh.

“Unë kam mësuar shumë gjatë kohës që kam kaluar në RrGGK, kam mësuar si të shkruaj projekt propozime dhe për ndikimin e Integritimeve Evropiane tek gratë. Kjo eksperiencë ka qenë e



jashtëzakonshme dhe shume e dobishme.” tha Jennifer.

Jennifer dhe Nikki kanë kontribuar për RrGGK-në në mënyra të ndryshme, duke filluar nga buletini mujor, materialet tjera për mardhënie me publikun dhe deri tek draftimi i koncepteve dhe projekt propozimeve, si dhe duke ofruar ndihmë për hulumtime që gjithmonë kemi dashur të bëjmë por nuk kemi arritur për shkak të kohës të limituar. Ne i falenderojmë ato për punën e palodhëshme dhe kontributin e tyre!

Nëse dëshironi të bëni praktikë në RrGGK, ju lutem dërgoni CV-në tuaj dhe një letër motivuese, çfarë dëshironi të bëni dhe çfarë dëshironi të mësoni nga përvoja në info@womensnetwork.org

Feministet e Reja të Kosovës do t'i bashkangjiten Karavanit Ndërkombëtar

Pas një pauze të vogël verore, [Iniciativa për Fuqizimin e Vajzave të Kosovës](#) po riaktivizohet, duke e nisur me një diskutim joformal që angazhoi një koalicion më të gjerë të feministeve të reja më 26 gusht në Prishtinë. Feministet e reja, në muajt e ardhshëm kërkojnë të zgjerojnë koalicionin duke avokuar për çështjet me rëndësi për feministet e Kosovës.

Takimi fillestar kishte një mysafire speciale: Milena Abrahamyan nga *Young Feminists of Europe Network* e cila ndau informatën lidhur me “Karvanin Feminist” ndërkombëtar, që do të mbahet prej 8 marsit deri me 17 tetor 2015. Në solidaritet me Marshimin Botëror të Grave (*World March of Women*), Karvani do të kalojë kufijë Evropian (e ndoshta edhe kufinj të tjerë). Tema kryesore e karavanit, siç u cek nga Milena, është “Globalizimi i Solidaritetit”. Ai do të mundohet të bashkojë feministë dhe grupe feministe të ndryshme në fusha të ndryshme. Ai do të vë në pah vështirësitë me të cilat përballen gratë në fusha të ndryshme, do të identifikojë ngjashmëritë dhe të inkurajojë bashkëpunimin në luftimin e çështjeve të pabarazisë.

Udhëtimi do të dokumentohet me anë të një emisioni në radio, në bashkëpunim me radio emisione në të gjitha vendet, dhe si pjesë e tij do të jetë një film dokumentar. Rrugëtimi i Karavanit nuk është caktuar ende përfundimisht. Ai do të fillojë në Angli ose në Turqi dhe pastaj do të vizitojë vende të ndryshme në mbështetje të ngjarjeve të planifikuara nga aktivistët në ato vende. Karvani patjetër do të përfundojë me një ngjarje të madhe në Portugali. Feministet mund t'i bashkohen Karavanit për cilëndo pjesë të udhëtimit, ose gjatë gjithë kohës.

Një debat i nxehtë mes pjesëmarrëseve të mundshme nga Kosova ngriti çështjen nëse burrat dhe personat të cilët identifikohen me gjini të tjera, mund të marrin pjesë në Karavan. Debat i përfundoi me pyetjen nëse ky është "një Karavan feminist apo i grave?" Milena do të parashtrojë këtë pyetje dhe çështje tjera që u diskutuan te organizatorët e Karvanit. Një përgjigje përfundimtare do të jepet në faqen e tyre dhe/ose në faqen e Facebook, ku të interesuarit mund të mbledhin informata shtesë lidhur me Karvanin, posa ato të jenë në dispozicion.

Pjesëmarrëset e Kosovës ishin shumë të interesuara për të mësuar më shumë për *Young Feminists of Europe Network* dhe planet e ardhshme për Iniciativën për Fuqizimin e Vajzave të Kosovës. Në mbledhjen e ardhshme informale dhe argëtuese, të planifikuar për të martën, me 2 shtator në “Si n'Bahçe” në Prishtinë, feministet e reja do të diskutojnë ide specifike, aktivitete për iniciativat avokuese dhe fuqizimin e feministeve të reja në Kosovë. Ejani bashkohuni me ne!

P.S. Diskutimet do të vazhdojnë edhe në rajone të tjera të Kosovës në javët që do të vijë - kështu që nëse ju nuk mund të vini në Prishtinë, mos u shqetësoni - ne do të vizitojmë zonën tuaj së shpejti!